

KONTRATË PËR DHURIMIN E KUOTAVE

Sot me date 20.02.2022 palët e mëposhtme lidhen këtë Kontrate për Dhurimin e Kuotave të Kapitalit (më poshtë quajtur “Kontrata”):

1. **Znj. Vera Skendaj**, me nr. personal F05530024T, banuese ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Ada Tower, Tirane,
2. **Z. Gjergj Skendaj**, me nr. personal I10829047J, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Ada Tower, Tirane,
3. **Znj. Anisa Skendaj**, me nr. personal I41217090I, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Ada Tower, Tirane,

(te gjithë do te quhen më poshtë “Pala Dhuruese”)

Dhe

4. **Znj. Jonida Skendaj**, me nr. personal I05226155I, banuese ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Ada Tower, Tirane,

(që më poshtë do të quhet “Pala Pranuese e Dhurimit ”)

MEQËNËSE

- A. Znj. Vera Skendaj zoteron 1 kuote, qe perfaqeson 3,75% te kapitalit te shoqerise ReNRGY Trading Group Shpk., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar dhe qe ekziston sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, me NUIS L81818026N (“Shoqeria”), te cilen ka shprehur vullnetin dhe deshiren per t’ia dhuruar Pales Pranuese te Dhurimit (“Dhurimi 1”).
- B. Znj. Anisa Skendaj zoteron 1 kuote, qe perfaqeson 3,75% te kapitalit te Shoqerise, te cilen ka shprehur vullnetin dhe deshiren per t’ia dhuruar Pales Pranuese te Dhurimit (“Dhurimi 2”).
- C. Z. Gjergj Skendaj zoteron 1 kuote, qe perfaqeson 33,75% te kapitalit te Shoqerise, nga e cila ka shprehur vullnetin dhe deshiren per ti dhuruar Pales Pranuese te Dhurimit 3,75% te kapitalit te Shoqerise qe i takon (“Dhurimi 3”).
- D. Znj. Jonida Skendaj, Pala Pranuese e Dhurimit eshte tashme ortak e Shoqerise dhe zoteron 1 kuote qe perfaqeson 3,75% te kapitalit te Shoqerise.

Duke patur parasysh sa më lart Palët bien dakord për sa vijon:

NENI 1

DHURIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT

- 1.1 Me nënshkrimin e kesaj Kontrate, Pala Dhuruese i dhuron Pales Pranuese te Dhurimit dhe Pala Pranuese e Dhurimit pranon dhurimin nga Pala Dhuruese si me poshte:
- Znj. Vera Skendaj dhuron te tere kuoten e saj qe perfaqeson 3,75% te kapitalit te Shoqerise
 - Znj. Anisa Skendaj dhuron te tere kuoten e saj qe perfaqeson 3,75% te kapitalit te Shoqerise
 - Z. Gjergj Skendaj dhuron pjeserisht nga kuota e tij 3.75% te kapitalit te Shoqerise.
- 1.2 Me nënshkrimin e kesaj Kontrate, Pala Pranuese e Dhurimit, tashme ortak e Shoqerise dhe zoteruese e 3.75% te kapitalit te Shoqerise, behet pronare e 1 kuote qe perfaqeson 15% te kapitalit te Shoqerise, me te drejta te plota pronesie nga data e kesaj Kontrate.

NENI 2

DEKLARIME DHE GARANCI

- 2.1 Pala Dhuruese deklaron dhe garanton se: (i) jane ortak e në një person juridik, i krijuar dhe regjistruar sipas ligjit të shtetit shqiptar (ii) kjo Kontratë përbën detyrim ligjor, të vlefshëm, të detyrueshëm dhe të pashmangshëm për Palen Dhuruese.
- 2.2 Pala Pranuese e Dhurimit deklaron dhe garanton se: (i) merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje; (ii) merr përsipër të gjitha detyrimet që rrjedhin nga qënia anëtar i kësaj Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar; (iii) Pala Pranuese e Dhurimit është në dijeni të plotë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të Pales Dhuruese dhe i pranon Kuotat e Pales Dhuruese ashtu siç jane dhe pa asnjë pretendim tjetër në lidhje me to se bashku me cdo detyrim qe shoqeria ka marre si entitet juridik.

NENI 3

LIGJI ZBATUES, ZGJIDHJA E MOSMARRVESHJEVE DHE TE NDRYSHME

- 3.1 Për çështjet të cilat nuk janë parashikuar në këtë Kontratë apo që mund të rrjedhin prej saj do të zbatohet legjislacioni përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë i cili është ligji i zbatueshëm për këtë Kontratë.
- 3.2 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve të kësaj Kontrate në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Kontrate, nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim mes vetë palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit gjyqësor Tiranë, vendimet e së cilës janë të ankimeshme sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.
- 3.3 Në rast se ndonjë nen i kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm, atëherë ky nen do të veçohet; pavarësisht nga kjo, të gjitha nenet e tjera të kësaj Kontrate do të mbeten në fuqi

dhe të vlefshme. Asnjë nen i kësaj Kontrate nuk do të varet nga nene të tjera, përderisa nuk është shprehur ndryshe në Kontratë.


3.4 Kjo Kontrate përbën të gjithë marrëveshjen e arritur midis palëve, premtimet, deklaratimet, garancitë në lidhje me objektin e kësaj Kontrate. Ajo mbizoteron mbi çdo marrëveshje apo angazhim tjetër të Paleve me të njëjtin objekt. Asnjë ndryshim i kësaj Kontrate nuk do të jetë i vlefshëm nëse nuk bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga vete palët në këtë Kontratë.


3.5 Kjo Kontratë do të jetë detyruese për Palët dhe pasardhësit e tyre të deleguarve të caktuar.

Kjo kontratë hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj. Kontrata është hartuar dhe do të interpretohet në përputhje me legjislacionin shqiptar, në 4 (katër) kopje të njëjta, secila kopje në 3 (tre) flete në gjuhën shqipe.

PALET KONTRAKTORE

PALA DHURUESE



Znj. Vera Skendaj


Z. Gjergj Skendaj


Znj. Anisa Skendaj


Anisa Skendaj

PALA PRANUESE E DHURIMIT


Znj. Jonida Skendaj

